

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

Shpresa Beçaj	Kryesuese
Gani Dizdari	Anëtar
Arjana Fullani	Anëtare
Shkëlzen Selimi	Anëtar
Edmond Islamaj	Anëtar

në seancën gjyqësore të datës 25.01.2012, mori në shqyrtim çështjen penale nr.52104-01372-00-2011, që i përket:

TË GJYKUARIT: ALDO BARE (ALFRED SHKURTI)

A K U Z U A R:

Për “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese”,
“Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit”,
“Shkatërrimit të pronës me zjarr”,
“Krijimit të organizatës kriminale”,
dhe “Kryerjes së veprave penale nga organizata kriminale”,
vepra të parashikuara nga nenet 79/dh-22, 78/2, 78-22, 78-22,
278/2, 151/2, 333 dhe 334 të Kodit Penal,
nën masën e sigurimit “arrest në burg”.

KËRKUES:	PROKURORIA E SHKALLËS SË PARË PËR KRIMET E RËNDA TIRANË.
ANKUES:	PROKURORIA E APELIT PËR KRIMET E RËNDA TIRANË.

Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, me vendimin nr.17, datë 28.03.2011 ka vendosur:

Deklarimin fajtor të të pandehurit **Aldo Bare (Alfred Shkurti)** për kryerjen e veprës penale të “Vrasjes në rrethana të tjera cilësuese”, në dëm të Genci Kashari e Artur Daja, mbetur në tentativë, e parashikuar nga nenet 79/dh, 22, 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 23 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Aldo Bare (Alfred Shkurti) për kryerjen e veprës penale të “Vrasjes me paramendim”, në dëm të Xhevat Demiri, e parashikuar nga neni 78/2 të Kodit Penal dhe në bazë të neneve 78/2, 334, 3/3 të Kodit Penal, dënimin e tij me burgim të përjetshëm.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Aldo Bare (Alfred Shkurti) për kryerjen e veprës penale të “Vrasjes me paramendim”, në dëm të Nimet Zeneli, e parashikuar nga neni 78/2 të Kodit Penal dhe në bazë të neneve 78/2, 334, 3/3 të Kodit Penal, dënimin e tij me 25 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Aldo Bare (Alfred Shkurti) për kryerjen e veprës penale të “Vrasjes me paramendim”, mbetur në tentativë, në dëm të Gramoz Selmani, e parashikuar nga neni 78/2-22 të Kodit Penal dhe në bazë të neneve 78/2-22, 334, 3/3 të Kodit Penal, dënimin e tij me 25 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Aldo Bare (Alfred Shkurti) për kryerjen e veprës penale të “Vrasjes me paramendim”, mbetur në tentativë, në dëm të Masar Aliu, e parashikuar nga neni 78/2-22 të Kodit Penal dhe në bazë të neneve 78/2-22, 334, 3/3 të Kodit Penal, dënimin e tij me 25 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Aldo Bare (Alfred Shkurti) për kryerjen e veprës penale të “Vrasjes me paramendim”, në dëm të Masar Aliu, e parashikuar nga neni 78/2-22 të Kodit Penal dhe në bazë të neneve 78/2-22, 334, 3/3 të Kodit Penal, dënimin e tij me 25 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Aldo Bare (Alfred Shkurti) për kryerjen e veprës penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe e municionit”, e parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim

Deklarimin fajtor të të pandehurit Aldo Bare (Alfred Shkurti) për kryerjen e veprës penale të “Shkatërrimit të pronës me zjarr”, të banesës së shtetasit Shkëlqim Haxhiu, e parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal dhe në bazë të neneve 151/2, 334, 3/3 të Kodit Penal, dënimin e tij me 10 vjet burgim

Deklarimin fajtor të të pandehurit Aldo Bare (Alfred Shkurti) për kryerjen e veprës penale të “Krijimit të organizatën kriminale”, e parashikuar nga neni 333 i Kodit Penal dhe në bazë të neneve 333, 3/3 dënimin e tij me 8 vjet burgim

Në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal e dënon të pandehurin **Aldo Bare (Alfred Shkurti) me burgim të përjetshëm**, duke filluar vuajtja e dënimit nga data e arrestimit.

Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, me vendimin nr.54 datë 03.10.2011 ka vendosur:

Prishjen e vendimit nr.17, datë 28.03.2011 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, në datën 24.10.2011, ka paraqitur rekurs Prokuroria e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, me anën e të cilit ka kërkuar: Prishjen e vendimit nr.54, datë 03.10.2011 të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në të njëjtën gjykatë, me trup tjetër gjykues.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, në datën 31.10.2011, nëpërmjet avokatit të tij, ka paraqitur rekurs i gjykuari Aldo Bare (Alfred Shkurti), me anën e të cilit ka kërkuar: Prishjen e vendimit nr.54, datë 03.10.2011 të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, dhe pushimin e çështjes për Aldo Bare (Alfred Shkurti), duke urdhëruar lirimin e menjëhershëm të tij.

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjo i relatorin e çështjes Edmond Islamaj; prokurorin Artur Selmani, i cili kërko i prishjen e vendimit nr.54, datë 03.10.2011 të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë, me një tjetër trup gjykues; dhe mbrojtësin e personit të gjykuar Aldo Bare, av.Vladimir Meçe, i cili kërko i lënien në fuqi të

vendimit nr.54, datë 03.10.2011 të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë; dhe pasi analizoi dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Se vendimi nr.54, datë 03.10.2011 i Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, që ka vendosur “Prishjen e vendimit nr.17, datë 28.03.2011 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues”, është rezultat i zbatimit të gabuar të ligjit e si i tillë duhet të priset.

A. Rrethanat e çështjes

1. I gjykuari Aldo Bare (Alfred Shkurti) dhe shtetasi Alfred Daja, në kohën e ngjarjeve kanë qenë banorë të qytetit të Lushnjës, dhe në konflikt me njëri tjetrin.
2. Ata kishin grumbulluar rreth vetes persona me të kaluar dhe sjellje kriminale.
3. Në datën 02.07.1997, gjatë një përplasje me armë zjarri, kanë ngelur të vrarë Ramadan Shkurti (vëllai i të gjykuarit Aldo Bare (Alfred Shkurti) dhe shtetasi Bardhyl Rabija, dhe mundën të largohen nga vendi ngjarjes i gjykuari Aldo Bare (Alfred Shkurti) dhe Enver Rabija.
4. Kjo ngjarje shërbeu si moment fillestar i krijimit të Organizatës Kriminale të ashtuquajtur “Banda e Lushnjës”, apo “Grupi i çunave të Alfred Shkurtit”
5. Nga grupi i tjetër rival në ngjarjen e kësaj date, ngeli i vrarë shtetasi Genci Kashari dhe u plagos shtetasi Artur Daja.
6. Pjesëmarrës aktivë në ngjarje, veç subjekteve të tjerë, ishte dhe i gjykuari Aldo Bare (Alfred Shkurti).
7. Në datë 03.08.1997 në qytetin e Lushnjës është vrarë me armë zjarri shtetasi shqiptaro-maqedonas Xhevat Demiri.
8. Në hyrje të qytetit të Lushnjës, viktimat së bashku me familjarë të tij, të cilët ishin duke udhëtuar me një furgon në drejtim të qytetit të Lushnjës, janë ndaluar nga i gjykuari Aldo Bare, së bashku me Afrim Hoxha, Enver Dondollakun dhe Ilir Stergun.
9. Këta të fundit, pasi kanë vënë maska në kokë, kanë zbritur nga furgoni shtetasin Xhevat Demiri, dhe më pas e kanë qëlluar me armë zjarri, duke i shkaktuar vdekjen.
10. Më datë 13.02.1998, në vendin e quajtur Kolonjë të Rrethit Lushnjë është vrarë me armë zjarri shtetasi Nimet Zeneli.
11. Në rrugën automobilistike, persona të armatosur, ndërmjet tyre dhe i gjykuari Alfred Shkurti (Aldo Bare), së bashku me të pandehurit në një procedim të lidhur, Arben Boriçi, Ilir Stergu dhe Enver Dondollaku, etj., i kanë zënë pritë fuoristradës tip “Tojota” me targa FR8079A.
12. Në fuoristradë udhëtonte shtetasi Gramoz Selmani, shoku i ngushtë i shtetasit Artur Daja, si dhe shtetasit Masar Aliu dhe Nimet Zeneli, shokë të shtetasit Gramoz Selmani.
13. Shtetasi Gramoz Selmani, pas ngjarjes së ndodhur në datën 02.07.1997, ishte një ndër personat për t’u eliminuar, i kërkuar nga grupi i Aldo Bares.
14. Arben Boriçi dhe Ilir Stergu, kanë vënë re që personat që udhëtonin me makinë kanë dalë nga rruga. I kanë ndjekur me vrap shtetasit Nimet Zeneli dhe Masar Aliu, duke qëlluar me armë në drejtim të tyre. Gjatë ndjekjes shtetasi Nimet Zeneli është plagosur me armë zjarri dhe nuk ka mundur të largohet. I pandehuri Ilir Stergu, së bashku me të pandehurin Arben Boriçi, i janë afuar të plagosurit Nimet Zeneli dhe kanë qëlluar në drejtim të tij me armë zjarri duke i shkaktuar vdekjen.
15. Shtetasi Masar Aliu ka mundur të largohet me vrap, duke i shpëtuar ekzekutimit.
16. Shtetasi Gramoz Selmani, i cili ishte fshehur poshtë makinës, është larguar nga krahu tjetër i rrugës. Sapo është parë nga i gjykuari Aldo Bare, i cili rrinte i ulur në një lokal

pranë rrugës bashkë me të pandehur Enver Dondollaku, është qëlluar me breshëri automatiku, por nuk është arritur vrasja e tij.

17. Në datë 22.02.1998 në rrugën Kolonjë–Bitaj të Rrethit Lushnjë, me qëllim vrasjen e shtetasit Masar Aliu, persona të armatosur, midis të cilëve të pandehurit Enver Dondollaku, Ilir Stergu dhe Arben Boriçi, kanë pritur ardhjen me makinë të shtetasit Masar Aliu.
18. Pasi kanë vënë re ardhjen e makinës kanë dalë dhe e kanë ndaluar atë dhe kanë qëlluar me armë zjarri në drejtim të shtetasit Masar Aliu, duke i shkaktuar vdekjen. Pas kësaj, kanë qëlluar dhe kanë vrarë edhe shtetasin Idajet Beqiri, i cili ka qenë rastësisht brenda në automjetin e Masar Aliut.
19. Në datën 22.08.2008 është shkatërruar me zjarr banesa e shtetasit Shkëlqim Haxhiu.
20. Persona të armatosur Ilir Stergu, Arben Boriçi, Aldo Bare, Enver Dondollaku, Leonard Prifti, etj., kanë shkuar në shtëpinë e shtetasit Shkëlqim Haxhiu, e cila ndodhej në lagjen “Loni Dharmo” në qytetin e Lushnjës.
21. Personat e armatosur janë futur me dhunë në shtëpinë e shtetasit Shkëlqim Haxhiu, duke hapur me forcë derën e katit të dytë të shtëpisë. Personat e armatosur kanë bërë kontroll në ambientet e brendshme të shtëpisë në kërkim të shtetasit Shkëlqim Haxhiu dhe djalit të tij Klodian Haxhiu. Pastaj pasi i kanë vënë zjarrin, janë larguar.
22. Ditën e vrasjes së Artur Dajës, në sheshin e qytetit të Lushnjës, pjesëtarë të grupit kriminal të drejtuar nga Aldo Bare kanë shëtitur nëpër shesh kokën e prerë të kufomës së Artur Dajës.
23. Organi i akuzës e ka akuzuar të gjykuarin Aldo Bare (Alfred Shkurti) për “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, “vrasje për hakmarrje”, “Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, vepra të parashikuara nga nenet 79/dh-22, 78/2-22, 78, 151/2, 278/2, 334, 333 të Kodit Penal.
24. Gjatë procedimit dhe gjykimit, i gjykuari Aldo Bare (Alfred Shkurti) ka kërkuar gjykim të shkurtuar, por gjykata e shkallës së parë nuk e ka lejuar.

B. Procedurat Gjyqësore

Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, me vendimin nr.17, datë 28.03.2011 ka vendosur:

- “Deklarimin fajtor të të pandehurit **Aldo Bare (Alfred Shkurti)** për kryerjen e veprës penale të “Vrasjes në rrethana të tjera cilësuese”, në dëm të Genci Kashari e Artur Daja, mbetur në tentativë, e parashikuar nga nenet 79/dh, 22, 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 23 vjet burgim.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit Aldo Bare (Alfred Shkurti) për kryerjen e veprës penale të “Vrasjes me paramendim”, në dëm të Xhevat Demiri, e parashikuar nga neni 78/2 të Kodit Penal dhe në bazë të neneve 78/2, 334, 3/3 të Kodit Penal, dënimin e tij me burgim të përjetshëm.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit Aldo Bare (Alfred Shkurti) për kryerjen e veprës penale të “Vrasjes me paramendim”, në dëm të Nimet Zeneli, e parashikuar nga neni 78/2 të Kodit Penal dhe në bazë të neneve 78/2, 334, 3/3 të Kodit Penal, dënimin e tij me 25 vjet burgim.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit Aldo Bare (Alfred Shkurti) për kryerjen e veprës penale të “Vrasjes me paramendim”, mbetur në tentativë, në dëm të Gramoz Selmani, e parashikuar nga neni 78/2-22 të Kodit Penal dhe në bazë të neneve 78/2-22, 334, 3/3 të Kodit Penal, dënimin e tij me 25 vjet burgim.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit Aldo Bare (Alfred Shkurti) për kryerjen e veprës penale të “Vrasjes me paramendim”, mbetur në tentativë, në dëm të Masar Aliu, e

parashikuar nga neni 78/2-22 të Kodit Penal dhe në bazë të neneve 78/2-22, 334, 3/3 të Kodit Penal, dënimin e tij me 25 vjet burgim.

- Deklarimin fajtor të të pandehurit Aldo Bare (Alfred Shkurti) për kryerjen e veprës penale të “Vrasjes me paramendim”, mbetur në tentativë, në dëm të Masar Aliu, e parashikuar nga neni 78/2-22 të Kodit Penal dhe në bazë të neneve 78/2-22, 334, 3/3 të Kodit Penal, dënimin e tij me 25 vjet burgim.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit Aldo Bare (Alfred Shkurti) për kryerjen e veprës penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe e municionit”, e parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim
- Deklarimin fajtor të të pandehurit Aldo Bare (Alfred Shkurti) për kryerjen e veprës penale të “Shkatërrimit të pronës me zjarr”, të banesës së shtetasit Shkëlqim Haxhiu, e parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal dhe në bazë të neneve 151/2, 334, 3/3 të Kodit Penal, dënimin e tij me 10 vjet burgim
- Deklarimin fajtor të të pandehurit Aldo Bare (Alfred Shkurti) për kryerjen e veprës penale të “Krijimit të organizatën kriminale”, e parashikuar nga neni 333 i Kodit Penal dhe në bazë të neneve 333, 3/3 dënimin e tij me 8 vjet burgim
- Në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal e dënon të pandehurin **Aldo Bare (Alfred Shkurti) me burgim të përjetshëm**, duke filluar vuajtja e dënimit nga data e arrestimit.

Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, me vendimin nr.54 datë 03.10.2011 ka vendosur:

“Prishjen e vendimit nr.17, datë 28.03.2011 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues”.

C. Arsytimi ligjor i vendimit të ankmuar

- Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë ka pranuar rrethanën e faktit të pretenduar nga prokurori, por ka ardhur në përfundim që cilësimi ligjor i akuzës duhej të ndryshohej në “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese” e të tjera vrasje me paramendim. Gjykata e ka deklaruar fajtor të gjykuar sipas akuzave, duke e përjashtuar nga dënimi për akuzën e vrasjes të shtetasit Luan Bilbili, e parashikuar nga neni 78 të Kodit Penal.
- Gjykata ka arritur në konkluzionin se *“nuk është akuzuar për këtë vepër penale Aldo Bare (Alfred Shkurti)”*.
- Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë ka pranuar të njëjtën rrethanë fakti sikurse Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë.
- Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë ka vendosur prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, duke arsyetuar në mënyrë të gabuar se:
 - a- Në seancën e datës 03.02.2010 gjykata ka vendosur të vazhdojë gjykimin pa praninë e të pandehurit, megjithëse ai kishte kërkuar pjesëmarrjen e tij në këtë fazë të gjykimit. I pandehuri nuk është paraqitur në gjykim pasi ka qenë i sëmurë. Faktin, e ka konfirmuar dhe mjekja e burgut, por ajo ka bërë shënimin se “i pandehuri mund të paraqitej në gjykim...”.
 - b- Seanca është zhvilluar në kundërshtim me nenin 351/1 të Kodit të Procedurës Penale.
 - c- Sipas paragrafit të dytë të nenit 351 të Kodit të Procedurës Penale, ky vendim është i pavlefshëm pasi i pandehuri ka pasur arsye të justifikuara, për të mos u paraqitur në gjykim.
 - d- Seanca gjyqësore është zhvilluar në kundërshtim me nenet 50/1 e 351 të Kodit të Procedurës Penale, ajo është e pavlefshme.

- e- Kjo seancë ka sjellë dhe vendimin e ndërmjetëm të datës 10.02.2010, që ka rrëzuar kërkesat e të pandehurit të paraqitura në datën 27.01.2010 në lidhje me pavlefshmërinë e disa akteve të ndodhura në dosjen e procedimit penal nr.15, datë 07.02.2006.
- f- Gjykata ka lejuar shkelje në marrjen dhe administrimin e provave. Këto shkelje janë procedurale që kanë pasjellë një proces jo të rregullt gjyqësor.
- g- Gjykata ka administruar akte të ekspertimit të përpiluar nga ekspertë që nuk kanë bërë betimin ose, nga ekspertë që nuk janë caktuar fare për të kryer ekspertimin.
- h- Në aktin e ekspertimit balistik për vlerësim provash nr.29, datë 28.02.1998, nuk është caktuar emri i ekspertit në vendimin e caktimit të ekspertimit, si dhe nuk është bërë betimi i ekspertit.
- i- Për aktin e ekspertimit balistik nr.56, datë 09.05.1998, oficeri i policisë gjyqësore ka caktuar ekspert Aleksandër Mile, ndërkohë që aktin e ekspertimit e ka bërë eksperti Kristaq Andoni.
- j- Gjykata ka pyetur me shkelje të rënda procedurale shtetasin Gramoz Selmani”

D. Në lidhje me rekursin.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë nr.54, datë 03.10.2011, brenda afatit ligjor, ka paraqitur rekurs Prokuroria e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, me anën e të cilit ka kërkuar prishjen e vendimit nr.54, datë 03.10.2011 të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në të njëjtën gjykatë, me trup tjetër gjykses.

Prokuroria e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, në rekursin e paraqitur, ka parashtuar shkaqet që vijnë:

“Mungesa e të pandehurit Aldo Bare në seancën gjyqësore të datës 03.02.2010 ka qenë subjektive, e vullnetshme dhe jo e determinuar nga faktorë të tjerë objektive apo forcë madhore e për pasojë disponimi i gjykatës për deklarimin e mungesës së tij e vazhdimin e gjykimit në praninë e mbrojtësit të zgjedhur prej tij, është e harmonizuar plotësisht me përmbajtjen e ligjit procedural penal.

Vendimi i gjykatës së apelit është i pabazuar në ligj. Në pikën 2, të nenit 351 të Kodit të Procedurës Penale, është përcaktuar se “Vendimi që deklaron mungesën është i pavlefshëm kur provohet se ajo ka ardhur nga mosmarrja e njoftimit ose nga pamundësia absolute për t’u paraqitur”.

Nga procesverbalet e seancave gjyqësore del e vërtetuar se në datë 27.01.2010 ka qenë i pranishëm i pandehuri Aldo Bare dhe mbrojtësi i tij Vladimir Meçi dhe, në prani të tyre para gjykatës, prokurorët e çështjes kanë kërkuar kohë për paraqitjen e kundërshtimeve, lidhur me kërkesat për pavlefshmërinë e disa akteve.

Në seancën e datës 03.02.2010 prokurorët kanë lexuar dhe dorëzuar me shkrim parashtrimet e tyre.

Në datën 10.02.2010 Gjykata ka marrë vendimin në lidhje me kërkesat e të gjykuarit.

Lidhur me arsyetimin e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë se “Gjykata ka pyetur me shkelje të rënda procedurale shtetasin Gramoz Selmani... dispozitat e cituara nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë nuk vijnë në favor të arsyetimit të atij vendimi, por të qëndrimit të drejtë e ligjor të gjykatës së faktit.

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, duke gëzuar edhe të drejtat e gjykatës së një shkalle më të ulët, ka pasur mundësitë reale e atributet ligjore të vërë në vend ato që ajo i ka konsideruar shkelje procedurale

Në rrethana të tilla kërkojmë kthimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatën e apelit, me trup tjetër gjykses”.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë nr.54, datë 03.10.2011, brenda afatit ligjor, nëpërmjet avokatit të tij, ka paraqitur rekurs i gjykuari

Aldo Bare (Alfred Shkurti), me anën e të cilit ka kërkuar prishjen e vendimit nr.54, datë 03.10.2011 të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë dhe pushimin e çështjes për Aldo Bare (Alfred Shkurti), duke urdhëruar lirimin e menjëhershëm të tij.

I gjykuari Aldo Bare (Alfred Shkurti), në rekursin e paraqitur, ka parashtruar shkaqet që vijnë:

“Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda ka lejuar shkelje të rënda procedurale të kryera nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë , që kanë sjellë një proces jo të rregullt ligjor, duke tejkaluar afatet procedurale dhe afatet e një gjykimi të arsyeshëm. Gjykatat kanë dhunuar parimin e gjësë së gjykuar.

I pandehuri është deklaruar i pafajshëm me vendimin nr.289, datë 21.12.2001 nga Gjykata e Apelit Durrës për veprën penale të “Krijimit të bandës së armatosur” dhe përsëri është dënuar për të njëjtat veprime si organizatë kriminale.

Në këtë gjykim janë shkelur parimet e prezumimit të pafajësisë, pasi i pandehuri është paragjykuar pa u paraqitur fare në gjykim.

Në gjykim janë përdorur prova që janë absolutisht të pavlefshme dhe të marra në kundërshtim me ligjin.

Për të gjitha episodet e akuzës që kanë të bëjnë me vrasjet e personave që akuzohet i pandehuri, provat janë të pavlefshme, pasi janë marrë në rrugë jo ligjore dhe të manipuluar.

Në gjykim është pyetur Gramoz Selmani me cilësinë e bashkë të pandehurit si dëshmitar. Marrja dhe pyetja e Gramoz Selmanit është e manipuluar, kur ai vetë ka pasur akuzë për 6 vrasje dhe masë sigurimi arrest në burg. Gramoz Selmani ka qenë i interesuar që çdo gjë t’i ngarkohet Aldo Bares në këmbim dhe të lirisë së tij.

Policia gjyqësore ka marrë të dhëna nga persona të paidentifikuar sipas ligjit dhe pa autorizim të prokurorit jashtë shtetit dhe nuk ka bërë as sigurimin e këtyre provave.

Gjykata ka administruar akte ekspertimi që janë haptazi të manipuluar, të pavlefshëm dhe të përpiluara nga persona që nuk janë caktuar si të tillë dhe që nuk kanë bërë asnjë lloj betimi. Këto akte kanë çuar në përfundim të gabuar për gjykatën.

E. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes

Duke pasur parasysh gjithë sa më sipër, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në materialet e gjykimeve rezultojnë të jenë respektuar parimet bazë të gjykimit penal dhe, nuk konstatohen shkelje që kanë të bëjnë me pavlefshmëri të procesit penal apo të akteve të rrjedhura prej tij.

Rekurset e Prokurorisë së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë dhe të të gjykuarit Aldo Bare (Alfred Shkurti) janë paraqitur brenda afatit ligjor.

Rezulton që Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë të ketë marrë në analizë dhe të ketë vlerësuar të gjithë pretendimet e ngritura, gjatë gjykimeve dhe në ankim nga palët.

Pretendimet e ngritura në rekurs nga i gjykuari Aldo Bare (Alfred Shkurti), në lidhje me cilësimin ligjor të akuzës, të realizuara nga gjykata e shkallës së parë, nuk janë vlerësuar nga gjykata e apelit.

Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë nuk e ka shqyrtuar çështjen në themel dhe, për këtë arsye rekursi i paraqitur nga i pandehuri Aldo Bare nuk mund të merret në shqyrtim nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, sepse të gjitha pretendimet e të pandehurit parashtruar në rekurs, kanë të bëjnë me zgjidhjen e çështjes në themel dhe jo në këtë fazë të gjykimit në të cilën ndodhet aktualisht.

Për sa i përket pretendimeve të ngritura në rekurs nga Prokuroria e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, ato gjenden të bazuara në ligj dhe si të tilla duhen pranuar. Gjykata e apelit, në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale, të përvijuara edhe nga praktika e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe e GJEDNJ, ka konsideruar elementë

të procesit jo të rregullt ligjor, shkelje të tilla të cilat nuk kanë ndikuar në realizimin e të drejtës.

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka vlerësuar në mënyrë jo të drejtë faktin kur, arsyeton se, mospjesëmarrja e të gjykuarit në seancën e datës 03.02.2010 sjell pavlefshmërinë e gjykimit.

Ky arsyetim i gjykatës është i gabuar, përveç faktit se mungesa e të gjykuarit Bare në këtë seancë ka qenë plotësisht e vullnetshme dhe se nuk rezulton të ketë pasur ndonjë pengesë objektive (*Faktin e ka konfirmuar mjekja e burgut, pasi është ajo e cila ka bërë shënimin se “i pandehuri mund të paraqitet në gjykim...”*), që e ka penguar atë të marrë pjesë në seancë. Por, Kolegji konstaton se kjo seancë gjyqësore i ka shërbyer marrjes së kundërshtimeve të Prokurorisë ndaj kërkesave të parashtruara nga mbrojtja në seancën paraardhëse të datës 27.01.2010. Pra, edhe sikur për një moment të analizohet se prokurori i seancës do të zgjidhte të mos parashtronte asnjë kundërshtim, kjo nuk do të thotë se mbrojtjes i është shkelur e drejta për një gjykim të rregullt pasi e drejta e parashtrimit kundërshtues i përket prokurorit dhe jo mbrojtjes apo të pandehurit, të cilët e kishin ushtruar të drejtën e tyre për të parashtruar kërkesa që në seancën e datës 27.01.2010.

Ndërsa në seancën e datës 10.03.2010 kur gjykata ka dhënë vendimin e saj rreth kërkesave të të pandehurit të paraqitura, i gjykuari Bare dhe mbrojtësi i tij kanë qenë të pranishëm. Pra nuk mund të thuhet se të gjykuarit i është mohuar e drejta për akses në gjykatë, e drejta për t'u mbrojtur apo e drejta për të parashtruar kërkesa para gjykatës, edhe sikur ajo të mos ketë pasur fare mundësi të dëgjojë kundërshtimet e prokurorit rreth kërkesave që ajo i ka paraqitur gjykatës.

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka gabuar kur ka vlerësuar si shkelje procedurale me pasojë pavlefshmërinë e vendimit të gjykatës, faktin se i pandehuri Gramoz SELMANI është paralajmëruar për përgjegjësi penale për dëshmi të rreme para se ai të bënte deklarime para gjykatës.

Është e vërtetë se një paralajmërim i tillë për dëshmi të rreme nuk i bëhet të pandehurit qoftë edhe bashkë të pandehurit që deklarohet lidhur me akuzën e një bashkë të pandehuri tjetër. Në Kodin e Procedurës Penale nuk parashikohet asnjë lloj pavlefshmërie rreth bërjes së paralajmërimit në rastet kur nuk kërkohet, por vetëm pavlefshmëri e mos bërjes së paralajmërimit në rastet kur kjo është e detyrueshme të kryhet, siç është rasti i marrjes së deklarimeve nga ana e një dëshmitari apo eksperti.

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka gabuar kur ka vlerësuar si të dyshimtë identitetin e vërtetë të deklaruesve Artur DAJA, Stiliano DAJA, Lorenc DAJA dhe Afrim DAJA, pasi ky identitet nuk rezulton të jetë verifikuar në momentin e marrjes së deklarimeve prej tyre. Këto akte të hetimit paraprak i janë nënshtruar kontrollit të tyre nga i gjykuari dhe mbrojtja në përfundim të hetimit dhe ato nuk kanë parashtruar asnjë kundërshtim rreth vlefshmërisë së tyre. Së dyti, edhe sikur Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda do t'i lindnin dyshime rreth identitetit të deklaruesve, ajo nuk kishte asnjë pengesë të riçelte shqyrtimin gjyqësor të këtyre provave dhe të verifikonte vetë këtë identitet, pra është një veprim i cili mund të kryhet prej saj dhe nuk mund të përbëjë shkak për prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka gabuar kur ka vlerësuar se ekspertët kanë kryer ekspertime pa bërë më parë betimin.

Edhe në këtë rast Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka pasur të gjitha kompetencat që të vlerësonte aktet e ekspertimit dhe mënyrën e kryerjes së tyre. Konstatimi se ekspertët nuk kanë kryer betimin, edhe sikur ky konstatim të ketë qenë i saktë, nuk parashikohet nga Kodi i Procedurës Penale si shkak që e bën ekspertimin të pavlefshëm. Palët kanë pasur të drejtë të kontestojnë ekspertin dhe të kërkojnë përjashtimin e tij, qoftë edhe për faktin se ai nuk ka kryer betimin, duke e vlerësuar këtë rrethanë si rrethanë njëanshmërie të tij ose që nuk

garanton paanshmëri të tij. Por në fakt nuk rezulton që i gjykuari apo mbrojtja e tij ta kenë kërkuar përjashtimin e ekspertëve në fjalë kur ata janë njohur me aktin e ekspertimit në përfundim të fazës së hetimit paraprak.

Gjatë procesit gjyqësor, mund të konstatohen shkelje të ndryshme, por e rëndësishme është se jo çdo shkelje e ligjit mund të cënojë procesin e rregullt ligjor në aspektin kushtetues. Gjykata Kushtetuese në praktikën e saj, ka pohuar se: *“Jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt në aspektin e shkeljes së të drejtave kushtetuese”* dhe se, *“ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit dhe çdo të drejtë tjetër të njohur me Kushtetutë dhe me ligj (..) Gjykata Kushtetuese nr.7/2000; nr.25/2005; nr.57/2011).* Për më tepër që këto shkelje, në rastin konkret, nuk rezultojnë të kenë ndikuar në dhënien e vendimit ndaj të gjykuarit dhe mund të riparoheshin nga vetë Gjykata e Apelit për Krime të Rënda.

Edhe GJEDNJ-ja, në linjën e mosmbështetjes së qëndrimeve tepër formale dhe strikte nga gjykatat e vendeve anëtare, ka theksuar detyrimin që kanë këto gjykata për të interpretuar kërkesat procedurale në mënyrë proporcionale dhe të arsyeshme (*Stone Court Shipping Company, S.A. kundër Spanjës*, 28 Tetor 2003, §§ 33-35; *Pérez de Rada Cavanilles kundër Spanjës*, 28 Tetor 1998, § 45; *Miragall Escolano dhe të tjerë kundër Spanjës*, 25 Janar 2000, §§ 36-38).

Në Protokollin 14 të KEDNJ-së, në 1 Qershor 2010, është shtuar një kriter i ri për vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesave, sipas nenit 35 § 3 b) të Konventës së ndryshuar, i cili mbështetet në parimin *de minimis non curat praetor*.

Në esencë, ky parim kërkon që autoriteti përkatës (gjykata rishikuese/gjykata më e lartë, në rastin konkret) nuk duhet të merret me çështje të vogla të papërfillshme.

GJEDNJ-ja e ka interpretuar këtë kriter të ri vlerësues si një filtër, duke mos i pranuar kërkesat në rastet kur kërkuar nuk ka pësuar ndonjë dëm të rëndësishëm/konsiderueshëm, përveç rasteve kur respektimi i të drejtave të njeriut të parashikuara në Konventë (KEDNJ) dhe Protokollin e Konventës, kërkon një shqyrtim të aplikimit për sa i përket thelbit (*Korolev kundër Rusisë*, no. 25551/05, 1 Qershor 2010; *Rinck kundër Francës*, no.18774/09, 19 Tetor 2010; *Stefanescu kundër Rumanisë*, no.11774/04, 12 Prill 2011; *Burov kundër Moldavisë*, no.38875/03, 14 Qershor 2011).

Në këto kushte, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se vendimi i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda **nr.54, datë 03.10.2011**, me të cilin është vendosur Prishjen e vendimit nr.17, datë 28.03.2011 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë, është rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit procedural penal dhe për këtë shkak duhet të priset.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 441/ç të Kodit të Procedurës Penale,

V E N D O S I

Prishjen e vendimit nr.54, datë 03.10.2011 të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë, me një tjetër trup gjykues.

Tiranë më, 25.01.2012